

URDHËR
Nr. 267, datë 3.8.2020

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN E TITULLIT
NDËRMJETËS TË FITUAR NË NJË SHTET TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 5, pika 5, si dhe të nenit 6/1-a, shkronja “ç” të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ministri i Drejtësisë i njeh shtetasit të huaj titullin ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj, nëse plotëson kushtet për t’u licencuar si ndërmjetës, sipas parashikimeve të ligjit për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë urdhër.

2. Kërkesa për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj, bashkë me dokumentacionin shoqërues, paraqitet pranë Ministrisë së Drejtësisë. Dokumentacioni i lëshuar nga autoriteti përkatës në vendin e huaj paraqitet i legalizuar/apostiluar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, sipas legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni shoqërues përbëhet nga:

- a) 2 fotografi;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) jetëshkrimi;
- ç) kopje të lejes, licencës ose aktit të lëshuar nga autoriteti përkatës, i cili sipas legjislacionit në shtetin e origjinës, i njeh të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit;
- d) kopje të diplomës ose dokumentacionit që vërteton përfundimin e studimeve të larta;
- dh) vërtetim sipas legjislacionit në shtetin e origjinës se shtetasi nuk është dënuar për kryerjen e veprave penale;
- e) dokumentacionin që vërteton ndjekjen e një programi trajnimi që lidhet me ndërmjetësimin;
- ë) vërtetim i lëshuar nga autoriteti licencues apo rregullator në shtetin e origjinës se ndërmjetësi është anëtar/regjistruar pranë këtij autoriteti dhe se ushtron në mënyrë aktive profesionin e ndërmjetësit.

3. Kërkesa për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj shqyrtohet brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, ka të drejtë të kërkojë nga shtetasi i huaj informacion ose plotësim dokumentacioni në rast se dokumentacioni nuk paraqitet në përputhje me parashikimet e këtij urdhri, si dhe verifikim të të dhënave nga institucionet vendëse dhe të huaja. Afati për plotësimin e dokumentacionit dhe/ose verifikimin e të dhënave është jo më shumë se 30 ditë.

5. Mosparaqitja e dokumentacionit ose e informacionit të kërkuar nga ana e shtetasit të huaj, brenda afatit 30-ditor, përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Në rast se institucionet vendëse dhe/ose të huaja, nuk paraqesin informacionin mbi të dhënat për të cilat është kërkuar verifikimi brenda afatit 30-ditor, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë merr në konsideratë mungesën e përgjigjes ndaj kërkesës për informacion për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara janë të domosdoshme për shqyrtimin e kërkesës, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë i propozon ministrit pezullimin e procedurës dhe njoftimin e kërkuarit për këtë fakt.

6. Struktura përgjegjëse pas shqyrtimit të kërkesës harton një relacion shpjegues në të cilin pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur, si dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e origjinës. Relacioni

bashkë me urdhrin përkatës, i paraqiten për miratim ministrit të Drejtësisë, i cili më pas vendos për njohjen ose jo të titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj.

7. Në rast pranimi të kërkesës për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë kryen regjistrimin e ndërmjetësit në Regjistrin e Ndërmjetësve, si dhe plotëson dosjen personale me dokumentacion, sipas rregullave të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Drejtësisë, “Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e administrimit të regjistrit të ndërmjetësve dhe dosjes personale të ndërmjetësit”.

8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

9. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)